



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja Nr. 95

Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-225

Prishtinë, më 25 Mars 2014, në orën 11:00.

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Hamza Balje, Flora Brovina
Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Nazane Breca, dhe Faton Topalli.

Munguan: Gëzim Kelmendi.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, Koordinatore e Komisionit, Muhamet Bytyçi, Zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 12.03.2014;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësor;**
- 5. Të ndryshme.**

***Kryesuesi,** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1. Miratimi i rendit të ditës

***Salihe Mustafa,** propozoj që në pika 5, të ndryshme, të diskutojmë lidhur me Projektligjin për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, se si mund të procedohet sa më shpejt në Kuvend .*

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2 . Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës: 12.03.2014;

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së datës:12.03.2014.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për produkte dhe pajisje medicinale;

Fikrim Damka - Tha se si Komisioni kemi punuar mjaft në këtë Projektligj, i kemi propozuar amendamentet tona dhe të njëjtat i kemi miratuar.

Raportin me Amendamente e kemi përcjell tek katër komisionet e përhershme, nga të cilat nuk kemi pranuar asnjë vërejtje lidhur me amendamentet tona. Atëherë ne sot si komision do të diskutojmë dhe miratojmë raportin përfundimtar për Projektligjin për produkte dhe pajisje medicinale.

Komisioni, Pas diskutimeve njëzëri miratoj raportin përfundimtar për Projektligjin për produkte medicinale dhe pajisje medicinale.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Sigurimin Shëndetësor;

Fikrim Damka, Tha do të vazhdojmë me shqyrtimin e projektligjit për Sigurimin Shëndetësor, ju e dini se si grup punues e kemi shqyrtuar dhe amendamentuar këtë projektligj, ku kemi propozuar disa amendamente, andaj konsiderojë se mund të vazhdojmë me miratimin e tyre një nga një . A pajtoheni që të vazhdojmë me miratimin e amendamenteve.

Komisioni, njëzëti u pajtua që të miratohen fillimisht amendamentet një nga një.

Fikrim Damka, Tha se grupi punues ka propozuar këto amendamente si vijon :

Amendamenti 1

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. fjalia “ose personi i” zëvendësohet me “dhe personin e”.

Komisioni miratoi amendamentin e parë.

Amendamenti 2

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. riformulohet si ne vijim:

1.2.“**Banor**”, nënkupton bartësin e lejes së qëndrimit të lëshuar nga autoriteti kompetent për territorin e Republikës së Kosovës dhe personin që ka aplikuar për njohjen e statusit të refugjatit.

Komisioni miratoi amendamentin e dytë.

Amendamenti 3

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. riformulohet si vijon:

1.3.“Fondi i Sigurimeve Shëndetësore” (në tekstin e mëtejshëm Fondi), nënkupton institucionin publik të sigurimit shëndetësor me statusin e personit juridik me të drejta, obligime, përgjegjësi dhe autorizime të veçanta për zbatim të këtij Ligji në emër të siguruarve përfshirë mbledhjen efektive të mjeteve financiare për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë.

Komisioni miratoi amendamentin e tretë.

Amendamenti 4

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. pas fjalës personin shtohet fjalia “i cili mund të dëshmoj se”.

Komisioni miratoi amendamentin e katërt.

Amendamenti 5

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5. riformulohet si vijon:

1.5.“Anëtarë të familjes së ngushtë”, në kuptim të këtij ligji konsiderohen: bashkëshorti/ja, prindërit, fëmijët deri në moshën 18 vjeçare përfshirë fëmijët e adoptuar, thjeshtri/a, njerku/a.

Komisioni miratoi amendamentin e pestë.

Amendamenti 6

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7. riformulohet si vijon:

1.7. “Punëdhënës”, - personi fizik ose juridik i cili i siguron punë të punësuarit dhe i paguan pagën për punën ose për shërbimet e kryera;

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtë.

Amendamenti 7

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8. riformulohet si vijon:

1.8.“Kujdesi shëndetësor”, nënkupton masat dhe veprimet që ndërmerren nga organizatat, institucionet, dhe profesionistët shëndetësorë, që për qëllim parësor kanë përmirësimin e shëndetit të qytetarëve dhe të banorëve;

Komisioni miratoi amendamentin e shtatë.

Amendamenti 8

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13. riformulohet si vijon:

1.13. “Bashkë-financimi”, nënkupton bashkë-sigurimin ose pagesën e kryer në formë të pjesëmarrjes në çmimin e shërbimit shëndetësor të mbuluar me sigurim nga bartësi i policës së sigurimit shëndetësor i cili sipas ligjit nuk është i liruar nga bashke-financimi i shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor.

Komisioni miratoi amendamentin e tetë.

Amendamenti 9

Në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14. pas fjalës “në fond” fshihet teksti në vazhdim.

Komisioni miratoi amendamentin e nëntë.

Amendamenti 10

Në nenin 3, paragrafi 1, pas nënparagrafit 1.15. shtohet edhe dy nënparagraf të ri 1.16 dhe 1.17. si në vijim:

1.16. “Periudha e pritjes”, nënkupton periudhën gjatë të cilës qytetari ose banori nuk arrin të paguaj premiumin e sigurimit shëndetësor gjatë tre (3) muajve radhazi.

1.17. “Emërtimi gjenerik”, nënkupton emërtimin e pambrojtur ndërkombëtar të barit ose materialit shpenzues medicinal.

Komisioni miratoi amendamentin e dhjetë.

Amendamenti 11

Në nenin 3, paragrafi 2, fshihet.

Komisioni miratoi amendamentin e njëmbëdhjetë.

Amendamenti 12

Neni 4, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Parimet themelore mbi të cilat ky Ligj do të zbatohet janë:

- 1.1. Transparenca e marrëdhënieve kontraktuale;
- 1.2. Qëndrueshmëria e shërbimeve të kontraktuara shëndetësore;
- 1.3. Barazia e qytetareve dhe banorëve;
- 1.4. Llogaridhënia e bartësve të institucioneve të kontraktuara shëndetësore dhe autoriteteve të fondit;
- 1.5. Qasja universale ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor;
- 1.6. Solidariteti i qytetarëve dhe banoreve si dhe punëdhënëseve;
- 1.7. Reciprociteti në marrëdhëniet bilaterale me shtetet dhe fondet tjera;

- 1.8. Përgjegjësia individuale me rastin e vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale;
- 1.9. Qasja e lehtë deri të institucionet e kontraktuara shëndetësore;
- 1.10. Efikasiteti i funksionimit të fondit;
- 1.11. Mbrojtja nga rreziku financiar i qytetarëve dhe banorëve gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

Komisioni miratoi amendamentin e dymbëdhjetë.

Amendamenti 13

Në nenin 6, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

- 2. Sigurimi shëndetësor i obligueshëm përfshin shërbimet e kujdesit shëndetësor themelor të ofruara në bazë të parimeve nga neni 4 i këtij Ligji.

Komisioni miratoi amendamentin e trembëdhjetë.

Amendamenti 14

Neni 7, paragrafi 1, fjala “statuti” zëvendësohet me fjalën “statusi”.

Komisioni miratoi amendamentin e katërbëdhjetë.

Amendamenti 15

Në nenin 7, paragrafin 1, pas nënparagrafit 1.2. shtohet një nënparagraf i ri si vijon:

- 1.3. Shërbimet esenciale shëndetësore për shtatzënat dhe lehonat.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëmbëdhjetë.

Amendamenti 16

Neni 7, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3. kalon si nënparagraf 1.4, dhe pas fjalës “Fondi” fshihet teksti në vazhdim.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëmbëdhjetë.

Amendamenti 17

Neni 9, fshihet fjalia “dhe sigurim shëndetësor vullnetar”.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëmbëdhjetë.

Amendamenti 18

Në nenin 11, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5, riformulohet si në vijim:

2.5. Invalidët e luftës, bashkëshorti/ja dhe fëmijët e tyre nën 18 vjet në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Komisioni miratoi amendamentin e tetëmbëdhjetë.

Amendamenti 19

Në nenin 11, paragrafi 3, nënparagrafi 3.4. riformulohet si vijon:

3.4. Anëtarët e ngushtë të familjeve të dëshmorëve.

Komisioni miratoi amendamentin e nëntëmbëdhjetë.

Amendamenti 20

Në nenin 11, paragrafi 3, nënparagrafi 3.5. pas fjalës Veteranët fshihet fjalia “dhe pjesëtarët”.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet.

Amendamenti 21

Në nenin 11, paragrafi 3, nënparagrafët 3.8, 3.9 dhe 3.10. bartën të paragrafi 2, pas nënparagrafit 2.5.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e një.

Amendamenti 22

Në nenin 11, paragrafi 3, pas nënparagrafit 3.7. shtohen tre (3) nënparagraf të ri si në vijim:

3.8. Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

3.9. Personat me aftësi të kufizuar.

3.10. Studentët.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e dy.

Amendamenti 23

Neni 12, paragrafi 2, riformulohet, si dhe ndahet në tre paragraf si vijon:

2. Personi i cili nuk arrin të paguaj premiumin gjatë tre (3) muajve radhazi - “periudha e pritjes”, i ndërpritet mbulesa me sigurim shëndetësor nga Fondi.

3. Për të ripërtëri mbulimin me sigurim, para se të fillohet shfrytëzimi i të drejtave nga sigurimi shëndetësor i obligueshëm, premiumi duhet të paguhet me kohë për të paktën tre (3) muaj radhazi pa ndërprerje ose për gjashtë (6) muaj me ndërprerje brenda 12 muajve të fundit.

4. Personi i cili e shfrytëzon periudhën e pritjes më shumë se tri (3) herë në pesë (5) vitet e fundit do të ndërpritet mbulimi me sigurim shëndetësor menjëherë pas dështimit për të paguar edhe një kësht të vetëm.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e tre.

Amendamenti 24

Neni 12, paragrafi 3, ndryshohet referenca, pas fjalës paragrafin 2 shtohet “3 dhe 4”.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e katër.

Amendamenti 25

Në nenin 13, paragrafin 1, në fund të paragrafit shtohet fjalia: “Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor e miratuar nga Qeveria sipas nenit 14, nuk mund të reduktohet gjatë vitit fiskal”.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e pestë.

Amendamenti 26

Në nenin 14, paragrafi 1, si dhe në tërë tekstin e ligjit fjala “Bord Mbikëqyrës” zëvendësohet me fjalën “Bord Drejtues”.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e gjashtë.

Amendamenti 27

Në nenin 14, paragrafi 2, ndahet në dy paragraf, si në vijim:

2. Lista nga paragrafi 1 i këtij neni përpilohet nga komisioni teknik bazuar në politikat e Ministrisë Shëndetësisë dhe mbi parimet e kosto-efektivitetit, mundësive dhe ndikimit në shëndet dhe produktivitetit;

3. Lista i dërgohet për miratim Bordit Drejtues të Fondit së bashku me deklaratën financiare të shpenzimeve për pakon e propozuar të shërbimeve; në pajtim me Kornizën Afat-mesme të Shpenzimeve, tre (3) muaj para fillimit të çdo viti fiskal.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e shtatë.

Amendamenti 28

Në nenin 14, paragrafin 5, fshihet referenca “dhe neni 12.3”.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e tetë.

Amendamenti 29

Në nenin 14, paragrafi 5, nënparagrafi 5.4, fshihet fjalia në fund të nënparagrafit “të bazuar në Direktivat relevante të Bashkësisë Evropiane”.

Komisioni miratoi amendamentin e njëzet e nëntë.

Amendamenti 30

Në nenin 14, paragrafin 6, fshihet referenca “dhe neni 12.3”.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë.

Amendamenti 31

Në nenin 14, paragrafi 6, nënparagrafi 6.6. riformulohet si në vijim:

6.6. Shfrytëzimin e shërbimeve funksionale stomatologjike, sipas Listës së përcaktuar nga Fondi;

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e një.

Amendamenti 32

Në nenin 14, paragrafi 6, pas nënparagrafit 6.7. shtohet një nënparagraf i ri si në vijim:

6.8. Shërbimet shëndetësore për shtatzëna dhe fëmijë.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e dy.

Amendamenti 33

Në nenin 15, paragrafi 2, zëvendësohet fjalia “ndërkombëtar të pambrojtur” me fjalën “gjenerik”.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e tre.

Amendamenti 34

Në nenin 16, paragrafin 2, fshihet referenca “dhe neni 12.3”.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e katër.

Amendamenti 35

Neni 17, emërtimi i nenit riformulohet si në vijim:

Shërbimet e përjashtuara nga Sigurimi Shëndetësor i Obligueshëm

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e pesë.

Amendamenti 36

Në nenin 17, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. riformulohet si vijon:

Frytnimin e asistuar, përveç për qytetarët dhe banorët e liruar nga pagesa e kontributeve të premiumit dhe bashkë-financimi të cilëve u lejohet një (1) procedurë si çift martesor në pajtim me ligjin, ndërsa për kategorinë e të siguruarve, kushtet dhe mbulueshmëria e përfituesve do të përcaktohen me akt nënligjor të propozuar nga Bordi Drejtues dhe të miratuar nga Qeveria.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e gjashtë.

Amendamenti 37

Neni 20, riformulohet si vijon:

Neni 20

E Drejta e Ankesës

1. Procedurat e realizimit të të drejtave për sigurimin shëndetësor të obligueshëm, sigurohen në pajtim me ligjet në fuqi.
2. Çdo i siguruar ka të drejtë ankese lidhur me pretendimet e tij që kanë të bëjnë me të drejtat për sigurimin shëndetësor të obligueshëm.
3. Ankesa parashtrohet brenda afatit tridhjetë (30) ditor të komisioni për shqyrtimin e Ankesave lidhur me Sigurimin Shëndetësor të Obligueshëm.
4. Komisioni për shqyrtimin e Ankesave lidhur me Sigurimin Shëndetësor të Obligueshëm themelohet me vendim nga Bordi Drejtues i Fondit.
5. Komisioni brenda afatit tridhjetë (30) ditë, shqyrton dhe vendos lidhur me Ankesën, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
6. Kundër vendimit të komisionit i siguruari mund të hapë kontest administrativ në gjykatën kompetente, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.
7. Përbërja, Kompetenca, Mandati dhe Puna e komisionit përcaktohet me akt normativ të cilin e nxjerr Fondi.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e shtatë.

Amendamenti 38

Neni 21, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. fjala “publik” zëvendësohet me “privat”.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e tetë.

Amendamenti 39

Në nenin 21, paragrafin 1, nënparagrafin 1.4. fshihet referenca “dhe neni 12.3”.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e nëntë.

Amendamenti 40

Në nenin 21, paragrafi 1, nënparagrafët 1.5 dhe 1.6, bashkohen dhe riformulohet si në vijim:

1.5. Pagesa nga shtetet e tjera, sipas marrëveshjeve ndërshtetërore dhe fondet e sigurimeve shëndetësore të shteteve të tjera në bazë të marrëveshjeve bilaterale.

Komisioni miratoi amendamentin e katërdhjetë.

Amendamenti 41

Në nenin 21, përmirësohet radhitja e paragrafëve dhe në paragrafin 2, pas referencës 1.1, shtohet referenca “dhe 1.2”, kurse pas fjalës “të gjithë” shtohet fjala “të punësuarit”.

Komisioni miratoi amendamentin e katërdhjetë e një.

Amendamenti 42

Në nenin 22, paragrafi 1, fjalia “mund të jenë të bazuara” zëvendësohet me fjalën “bazohen”.

Komisioni miratoi amendamentin e katërdhjetë e dy.

Amendamenti 43

Në nenin 22, paragrafi 3, fjalia “mund t’i propozojë” zëvendësohet me “i propozon”.

Komisioni miratoi amendamentin e katërdhjetë e tre.

Amendamenti 44

Në nenin 23, paragrafi 2, fshihet fjalia “dhe zyreve të administrates tatimore”.

Komisioni miratoi amendamentin e tridhjetë e katër.

Amendamenti 45

Në nenin 23, paragrafi 4, fshihet fjala “mund”, kurse “do të jetë i” zëvendësohet me “është”.

Komisioni miratoi amendamentin e katerdhjetë e pesë.

Amendamenti 46

Në nenin 23, paragrafi 6, riformulohet si në vijim:

6. Fondi përcakton kushtet e pagesës, me akt normativ.

Komisioni miratoi amendamentin e katerdhjetë e gjashtë.

Amendamenti 47

Në nenin 24, paragrafi 1, në fillim të paragrafit fshihet lidhëza “do të”.

Komisioni miratoi amendamentin e katerdhjetë e shtatë

Amendamenti 48

Në nenin 25, paragrafi 3, fjala “Shkallët”, zëvendësohet me “Shkalla”, kurse fshihet lidhëza “do të”.

Komisioni miratoi amendamentin e katerdhjetë e tetë.

Amendamenti 49

Në nenin 25, paragrafi 4, teksti në fund të paragrafit “nga to bazuar në planifikimet buxhetore” zëvendësohet me tekstin “në pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi.

Komisioni miratoi amendamentin e katerdhjetë e nëntë.

Amendamenti 50

Në nenin 25, paragrafi 6, riformulohet si vijon:

Qytetarët që nuk regjistrohen në skemën e sigurimit të obligueshëm shëndetësor, do të paguajnë çmimin e shërbimit shëndetësor të ofruar, në bazë të çmimorës së miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në propozim të Fondit.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë.

Amendamenti 51

Në nenin 25, paragrafi 7, riformulohet si vijon:

Banorët që nuk regjistrohen në skemën e sigurimit të obligueshëm shëndetësor, qytetaret ose banoret e Kosovës që janë të siguruar jashtë vendit dhe shtetasit e huaj, nëse nuk ka marrëveshje Bilaterale do të paguajnë çmimin e shërbimit shëndetësor të ofruar, në bazë të çmimorës së veçantë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë më propozim të Fondit.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e një.

Amendamenti 52

Në nenin 25, paragrafët 8 dhe 9 fshihen.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e dy.

Amendamenti 53

Në nenin 26, paragrafin 1, fshihet fjala “nen-ligjor”.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e tre.

Amendamenti 54

Në nenin 27, paragrafi 3, në fund të paragrafit shtohet fjalia “dhe statusi i tyre rregullohet me akt nënligjor të propozuar nga Bordi Drejtues dhe të miratuar nga Qeveria”.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e katër.

Amendamenti 55

Në nenin 28, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4. fjala “Bordin Mbikëqyrës” zëvendësohet me fjalën “Qeveri”.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e pesë.

Amendamenti 56

Në nenin 28, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8. fshihet.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e gjashtë.

Amendamenti 57

Në nenin 28, paragrafi 1, në fund të nënparagrafit 1.11. shtohet teksti si vijon: “Bordit Drejtues i raporton Drejtori i Fondit në lidhje me zbatimin e të gjitha kontratave për shërbime shëndetësor”.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e shtatë.

Amendamenti 58

Neni 29, kalon para nenit 28, si dhe titulli dhe nënparagrafet 3.4, 3.5 dhe 3.6 riformulohen si vijon:

Neni 28

Organet Drejtuese të Fondit

3.4. Kryetari ose Përfaqësuesi i Odës së profesionistëve shëndetësorë;

3.5. Kryetari i Bordit ose Përfaqësuesi i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës;

3.6. Kryesuesi ose përfaqësuesi i drejtoratëve të Shëndetësisë të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e tetë.

Amendamenti 59

Neni 29, paragrafi 5, fshihet fjalia “përveç atyre të identifikuar në paragrafin 4 të këtij neni,”.

Komisioni miratoi amendamentin e pesëdhjetë e nëntë.

Amendamenti 60

Në nenin 29, paragrafin 6, nënparagrafi 6.3. fshihet fjala “me ligj” zëvendësohet me fjalinë “dispozitat ligjore në fuqi”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë.

Amendamenti 61

Në nenin 29, paragrafi 8, fshihet fjalia “nën koordinimin e Ministrisë së Shëndetësisë në pajtim me këtë Ligj”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e një.

Amendamenti 62

Neni 30, në fund të paragrafit shtohet fjalia “dhe raporton para Kuvendit së paku një herë në vit”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e dy.

Amendamenti 63

Neni 31, paragrafi 2, në fund të paragrafit fshihet fjalia “të akredituara në nivel ndërkombëtar”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e tre.

Amendamenti 64

Neni 31, paragrafi 3, pas fjalës paragrafi shtohet referenca “1”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e katër.

Amendamenti 65

Neni 31, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3. fshihet “/ose”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e pesë.

Amendamenti 66

Neni 31, paragrafi 3, nënparagrafi 3.9. fjala “ligjin” zëvendësohet me fjalinë “dispozitat ligjore ne fuqi”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e gjashtë.

Amendamenti 67

Neni 31, paragrafi 5, fjalia “ka të drejtë që të realizojë” zëvendësohet me fjalën “realizon”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e shtatë.

Amendamenti 68

Neni 32, paragrafi 1, riformulohet si vijon:

1. Mbikëqyrja e Fondit bëhet nga:

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e tetë.

Amendamenti 69

Neni 32, paragrafi 1, në fillimi të nënparagrafi 1.1.2. fshihet fjalia “Kërkon nga Drejtori dhe”.

Komisioni miratoi amendamentin e gjashtëdhjetë e nëntë.

Amendamenti 70

Neni 32, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.5. fshihet.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë.

Amendamenti 71

Neni 32, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.6. fjala “Përgatitë” zëvendësohet me fjalën “Aprovon”, kurse në fund të këtij nënparagrafi fshihet fjalia “si dhe trupat e tij”.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e një.

Amendamenti 72

Neni 32, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1.7. bartet tek nënparagrafi 1.2. Drejtori i fondit si nënparagraf 1.2.4. kurse pas fjalës individuale shtohet fjala “vjetore”.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e dy.

Amendamenti 73

Në nenin 34, paragrafi 1. Fjala “ligjin” zëvendësohet me fjalinë “dispozitat ligjore në fuqi”.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e tre.

Amendamenti 74

Në nenin 34, paragrafë 2, 3 dhe 4, fshihen.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e katër.

Amendamenti 75

Neni 35, në emërtimin e nenit shtohet fjala “dhe pagat”, kurse paragrafi riformulohet si vijon:

Kufiri maksimal i shpenzimeve administrative dhe i shpenzimeve për paga të punëtorëve të Fondit do të specifikohen në Rregulloren për Menaxhimin Financiar të Fondit të cilën e miraton Qeveria.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e pesë.

Amendamenti 76

Në nenin 36 pas paragrafit1, shtohet një paragraf i ri si vijon:

2. Sanksionet administrative nga paragrafi 1 i këtij neni shqiptohen nga Inspektorati Shëndetësor i Ministrisë së Shëndetësisë.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e gjashtë.

Amendamenti 77

Në nenin 37, paragrafin 2, zëvendësohet “vlerë prej 3.5 Euro” me “vlerë prej dy (2) Euro”, kurse fjala “përqindje” zëvendësohet me fjalën “vlerë”.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e shtatë.

Amendamenti 78

Në nenin 37, paragrafi 7, rregullohet referenca “nenin 24, paragrafi 1”.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e tetë.

Amendamenti 79

Në nenin 37, paragrafin 10, nënparagrafi 10.2, fshihet referenca “dhe neni 12.3”.

Komisioni miratoi amendamentin e shtatëdhjetë e nëntë.

Komisioni, Pas shqyrtimit dhe miratimit të amendamenteve veç e veç, njëzëri miratoi Projektligjin për Sigurimin Shëndetësor me amendamente e propozuara.

Kryetari, Projektligji për Sigurimin Shëndetësor procedohet me tej në katër komisionet e përhershme.

5. Të ndryshme.

Kryesuesi, të kalojmë të pika e fundit të ndryshme, kemi propozimin që të diskutojmë për Projektligjin për Veteranet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, urdhëroni znj. Salihe Mustafa.

Salihe Mustafa, tha se, si komision kemi vullnet për ti amendamentuar dhe përfunduar Projektligjet në procedurë, këtë e kemi dëshmuar siç ishte rasti i fundit me Projektligjin për Sigurimin Shëndetësor. Propozoj që edhe Projektligjin për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të fillojmë me shqyrtimin e tij si grup punues, dhe të procedojmë sa me shpejt në lexim të dytë.

Komisioni, pas diskutimeve njëzëri përkrahu propozimin lidhur me përshpejtimin e procedurave për shqyrtimin e Projektligjit për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Komisioni vendosi që nesër pas dëgjimit publik, të shqyrtojë dhe amendamentojë Projektligjin për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Kryesuesi, tha a kemi diçka tjetër të kjo pikë, po urdhëroni znj. Nazane Breca, keni fjalën.

Nazane Breca, Propozoj që si komision të kërkojmë informatë me shkrim nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, lidhur me masat që i kanë ndërmarrë lidhur me zbatimin e

Ligjit Nr. 04/l-150, për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, pasi që kemi disa informata se ka ngecje me zbatimin e këtij ligji.

Komisioni, njëzëri vendosi që të kërkojë informatë me shkrim nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, për masat dhe hapat që janë ndërmarrë për zbatimin e Ligjit Nr. 04/l-150, për Odat e Profesionistëve Shëndetësor, a janë nxjerr aktet nënligjorë që parashihen me këtë Ligj.

Kryesuesi, Falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka